



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2021:295170

Datë: 02.11.2022

Numri i dokumentit: 03600619

C.nr.2253/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Durim Balaj dhe bashkëpunëtoren profesionale Gresa Sadiku, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses M.H nga Komuna e Gjakovës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – DKA, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 1,328.40 euro, jashtë seance me datë 02 nëntor 2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses M.H, nga Komuna e Gjakovës.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – DKA, që paditëses në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 27% të pagës bazë për 24 muaj të licencimit dhe atë për periudhën kohore nga data 01.01.2019 deri me datë 31.12.2020 (për çdo muaj shumën nga 55.35 euro) të ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1.328.40 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 29.12.2021 (data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 228.00€, të gjitha në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja M.H, nga Komuna e Gjakovës në këtë gjykatë me datë 29.12.2021, përmes të autorizuarit të saj Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, ka ushtruar padi të cilën e ka precizuar me datë 19.10.2022 kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – DKA, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, duke theksuar se paditësja si mësimdhënëse në Institucionin Arsimor SH.M.U “Mustafa Bakija” në Gjakovë, ku e njëjta ka kualifikimin Bachelor i Edukimit, në Universitetin e Prishtinës, andaj në bazë të nenit 7, pika 1.3 të Kontratave Kolektive, në bazë të atij kualifikimi e paditura ka për obligim që paditëses ti paguaj pagën me 27% rritje mbi pagën bazë. Paditësja me padi kërkon që ti kompensohet shtesa

në pagë në bazë të kualifikimit, për periudhën kohore nga data 01.01.2019 deri me 31.12.2020. Në bazë të listës së pagave për atë periudhe kohore paditësja pagën bazë e ka pasur 421.00 euro x 27% që e paditura ka pasur për obligim që të ia kompensoj paditëses në bazë të kualifikimit të saj profesional shumë prej 113.67 euro. E paditura paditëses pjesërisht i ka kompensuar vetëm shumë prej 58.32 euro, andaj e njëjta kërkon që ti paguhet edhe pjesa tjetër prej 55.35 euro e cila nuk i është kompensuar. Në total paditëses për kriterin e diferencës në pagë në bazë të nenit 7, të KKAK-së e paditura duhet të i paguaj shumë prej 1,328.40 euro për periudhën kohore nga data 01.01.2019 e deri me 31.12.2020 për 24 muaj, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 09.08.2022, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se Komuna e Gjakovës nuk është nënshkruese e kontratës Kolektive të Arsimit si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve pasi që MASHT-i dhe SBASHK-u, nuk janë të angazhuar për t'i informuar dhe ndihmuar Komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos buxhetore për zbatimin e kësaj kontrate në Ministrinë e Financave me qëllim të realizimit të buxhetit etj. Po ashtu e paditura është thirrur edhe në institutin e parashkrimit, ku ka theksuar se: sipas nenit 87 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, "Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tre (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës". Ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë dhe precizimit të saj, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënin e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, precizimin e padisë dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura në Shkollën "Mustafa Bakija" në Gjakovë, si mësimdhënëse e lëndës së Biologjisë, se e njëjta ka diplomuar me datë 19.05.2014 dhe ka marrë titullin Bachelor i Biologji-Kimi, posedon licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës. Nuk është kontestuese as fakti se paga bazë e paditëses është 421.00 euro dhe në emër të licencës për çdo muaj i është paguar shuma prej 58.32 euro, në emër të kualifikimit Fakultet. Këto fakte gjykata i ka vërtetuar përmes provave që gjenden në shkresat e lëndës e që janë: Kontrata e punës për paditësen M.H, e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – DKA, këtu e paditura, e lidhur me datë 01.09.2015, në versionin e fotokopjuar e vërtetuar, me numër Leg.nr.9106/2021 e datës 07.09.2021, Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Edukimit – Qendra në Gjakovë me numër 710 e lëshuar me datë 19.05.2014. Licenca e mësimdhënësit me numër 100022426, Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për periudhat 01.12.2019-31.12.2019, dhe 01.02.2020-29.02.2020. Derisa në nenin 329 par. 1 të LPK-së parashihet që: "*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve*

*publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”, andaj gjykata provave të lartcekura që kishin të bënin me vërtetimin e këtyre fakteve, iu fali besimin e plotë, ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.*

Pretendimin e të paditurës të dhënë në përgjigje në padi se nuk ka planifikim buxhetor për këto kompensime, i gjen si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme dhe i vlerëson si të parëndësishme për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike kontestuese, nga fakti se e paditura në asnjë formë nuk e ka kontestuar faktin se paditësja është e punësuar tek e paditura dhe se në periudhën për të cilën kërkohet kompensimi të njëjtës nuk i është kompensuar pjesa tjetër e shtesave në emër të kualifikimit prej 55.35 euro, pra e paditura nuk e ka kontestuar as bazën e as lartësinë e kërkesëpadisë, por ka konsideruar se lidhur me këtë kërkesë të paditëses, e paditura nuk ka buxhet të mjaftueshëm, e që për gjykatën ky pretendim ishte irelevant dhe pa efekt juridik në mes të palëve, pasi që paditësja nuk është përgjegjës për planifikimin e buxhetit për obligimet që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e lartcekur, andaj edhe rrethanat subjektive të të paditurës lidhur me mos planifikimin me kohë të buxhetit për zbatimin e kontratës së lartcekur nuk e liron të njëjtën nga detyrimi për pagesën e këtyre shpenzimeve. E paditura po ashtu është thirr në institutin e parashkrimit përkatësisht në nenin 87 të Ligjit të Punës, mirëpo i autorizuari i paditëses me parashtrësën për precizimin e kërkesëpadisë të datës 19.10.2022, është tërhequr nga pjesa e parashkruar e kërkesës.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 sepse kërkesa për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit për vitin 2020 mbulohet nga Kontrata Kolektive e datës 18.04.2017. Në dispozitat e nenit 7 par.1 nën par. 1.3 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, parashihet që *“me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: 1.3. Mësimdhënës me diplomë fakultet tre dhe katër vjeçare 27% të pagës bazë”*, andaj gjykata erdhi në përfundim se paditëses i takon e drejta e kompensimit të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, më konkretisht të pjesës së pa kompensuar lidhur me këtë të drejtë monetare për çdo muaj për periudhën kohore nga data 01.01.2019 deri me datë 31.12.2020 për 24 muaj, ashtu që për këtë periudhë paditëses i takon diferenca në shumë prej 55.35 euro për çdo muaj, në shumën e përgjithshme prej 1,328.40 euro për këtë kriter të kompensimit.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, andaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë jashtë seance, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditëses është e themeltë për periudhën kohore për të cilën kërkohet kompensimi, për faktin se e njëjta bazohet në nenin 7 par.1 nën par. 1.3. të

Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, e që shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, është marrë sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç'rast paditësit iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 228.00.€. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00.-€ (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 104.00.-€, si dhe parashtesa e datës 19.10.2022 në shumë prej prej 104.00.-€ të paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17).

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË  
Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.2253/21, datë 02 nëntor 2022

G J Y Q T A R I  
Durim BALAJ

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykat